



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

**RREGULLORE**

**Nr. 9, datë 27.02.2019**

**PËR RREGULLIMIN DHE MBIKËQYRJEN E FUNKSIONIMIT TË  
PROFESIONIT TË KONTABILISTIT TË MIRATUAR DHE  
ORGANIZATAVE TË TYRE PROFESIONALE**

**TË**

**BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE**

Kjo rregullore është hartuar në bazë të:

Nenit 1, pika 1 dhe 2, Nenit 2, pika 6, Nenit 5, pika 2, Nenit 51, pika 1, 2 dhe 3, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi dhe objekti i kësaj rregullore**

1. Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e profesionit të kontabilistit të miratuar dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të profesionit të tij
2. Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të Organizatave të Kontabilistëve të Miratuar;
3. Kjo rregullore parashikon procesin e monitorimit të edukimit të vijueshëm të Kontabilistëve të Miratuar që ushtrjnë profesionin si dhe atyre profesionistëve që kanë fituar titullin si Kontabilist i Miratuar të cilët nuk janë ushtrues të profesionit së bashku me procedurat e regjistrimit në regjistrin publik;

4. Në këtë rregullore parashikohen rregullat e përgjithshme për mbikëqyrjen e procesit të edukimit të vijueshëm si dhe plotësimin e të gjitha kërkesave ligjore të kontabilistëve të miratuar, si dhe procesin e mbikëqyrjes së organizatave profesionale të Kontabilistëve të Miratuar;
5. Kjo rregullore parashikon procedurat e verifikimit të Kontabilistëve të Miratuar Aktivë dhe Kontabilistëve të Miratuar Jo-aktiv, si dhe kriteret për pajisjen me kartë profesionale.

## **Neni 2**

### **Shkurtime dhe Përkufizime**

1. Shkurtime e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

**KM** – Kontabilist i Miratuar

**KMA** – Kontabilist i Miratuar Aktiv (ushtrues i profesionit) i cili është personi fizik, profesionist i lirë, i regjistruar në regjistrin e njëres prej organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar, që kontraktohet nga personi juridik, për të kryer shërbime të kontabilitetit. Ai mund të kryejë edhe shërbime të tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

**KMJ** – Kontabilist i Miratuar Jo-aktiv (jo ushtrues i profesionit), është person, i regjistruar në regjistrin e njëres prej organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar, i pezulluar me kërkesën e tij nga organizata përkatëse për kryerjen e shërbimeve të kontabilitetit.

**PPAP** – Provimi Përfundimtar i Aftësive Profesionale

**Person fizik** - është subjekti sipas kuptimit të Kodit Civil dhe ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, i cili ushtron një profesion të pavarur (Kontabilist të Miratuar).

**OP** – Organizatat Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar janë organizimet e profesionistëve kontabilistë, që kanë jo më pak se 50 anëtarë, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e shërbimeve të kontabilitetit, të organizuar përkatësisht në njëren nga organizatat profesionale të kontabilistëve, në të cilat përfshihen edhe shoqëritë e kontabilitetit.

**Grupi i punës për procesin e verifikimit** – Është komisioni Ad-Hoc i cili ngrihet pranë BMP-së në përputhje me këtë rregullore dhe kuadrin rregullator të BMP-së për shqyrtimin e dokumentacionit lidhur me ushtrimin e profesionit të KM. Anëtarët e këtij komisioni paguhen në përputhje me rregulloren për funksionimin e strukturës mbështetëse për ekspertët e jashtëm.

**SNRF** – Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar janë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK), standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) dhe interpretimet përkatëse (interpretimet e komitetit të përhershëm) (IKP) dhe interpretimet e komitetit të raportimit financiar ndërkombëtar (IKRFN), të miratuara nga bordi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit (BSNK - IASB).

**Shërbimet e Kontabilitetit** - janë shërbimet e mbajtjes dhe përgatitjes së librave kontabël, fiskalë dhe të pagave, të kontrollit dhe verifikimit të dokumentacionit kontabël, vlerësimet dhe analizat e kostos dhe kontabilitetit të drejtimit, vlerësimit dhe

zbatimit të procedurave kontabël të përgatitjes së pasqyrave financiare, analiza financiare dhe këshillime përkatëse, si dhe shërbime të tjera të ngjashme.

Shoqëri kontabiliteti – Është një person juridik, pavarësisht formës së organizimit, i regjistruar në regjistrin publik të kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit, i miratuar nga autoritetet kompetente për të kryer shërbime kontabiliteti dhe që plotëson kriteret e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

KVP – Kualifikim i vijueshëm profesional është procesi i edukimit të detyrueshëm që çdo KM duhet të kryej çdo vit në përputhje me këtë rregullore dhe ligjin Nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

KK – Janë kurset e kualifikimit në fushën e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar të detyrueshme për kandidatin përpara se të hyj në PPAP për të fituar titullin KM.

2. Të gjitha shkurtime të tjera të përdorura në këtë rregullore janë të njëjta me ato të përdorura në rregulloret e tjera të miratuara nga BMP dhe ato të përcaktuara në Ligjin Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

### **Neni 3**

#### **Ushtrimi i Profesionit**

1. Në përputhje me dispozitat e ligjit për auditimin, kontabilist i miratuar është personi fizik, profesionist i lirë, i regjistruar në regjistrin e njërës prej organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar, që kontraktohet nga personi juridik, për të kryer shërbime të kontabilitetit. Ai mund të kryej edhe shërbime të tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
2. Profesionit i kontabilistit të miratuar nga personat, që kanë fituar provimet e aftësisë profesionale dhe janë pajisur me “Certifikatë”, ushtrohet vetëm pas anëtarësimit të tyre në një organizatë profesionale të kontabilistëve të miratuar, të njohur nga bordi, e cila angazhohet për ndjekjen e standardeve profesionale, cilësisht të larta dhe për zbatimin e një kodi etike, që është në pajtim me kodin e etikës të IFAC-së.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në legjislacionin në fuqi ose kuadrin rregullator të miratuar nga BMP në përputhje me legjislacionin në fuqi shërbimet e kontabilitetit mund të realizohen edhe nga shoqëritë e kontabilitetit, që angazhojnë kontabilistë të miratuar, të cilët janë testuar nga Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale, sipas dispozitave të parashikuara në këtë rregullore. Shoqëritë e Kontabilitetit mund të kryejnë edhe shërbime të tjera, që nuk bien në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
4. Shoqëritë e kontabilitetit organizohen si shoqëri tregtare, në përputhje me ligjin e fushës përkatëse dhe duhet të administrohen nga një ose më shumë persona, të cilët janë të pajisur me certifikatën e kontabilistit të miratuar.

5. Shoqëritë e kontabilitetit për të ushtruar aktivitetin e tyre në shërbimet e kontabilitetit duhet të plotësojnë kushtet në vijim:
  - a) shumica e të drejtave të votës në kapitalin e shoqërisë zotërohen nga shoqëri e kontabilitetit, vendase ose të huaja, ose nga kontabilistë të miratuar;
  - b) të paktën 50 për qind e anëtarëve të organit drejtues ose administrativ të shoqërisë së kontabiliteti janë KM të njohur nga Komiteti i Regjistrimit të OP dhe të regjistruar në regjistrin publik të kontabilistëve të miratuar. Kur organi drejtues ose administrativ nuk ka më shumë se dy anëtarë, të paktën njëri prej këtyre anëtarëve duhet të plotësojë kushtet e përmendura në këtë shkronjë;
  - c) shoqëria angazhon kontabilist të miratuar të cilët janë të regjistruar në regjistrin publik të kontabilistëve të miratuar.
6. Përveç dispozitave të parashikuara në këtë nen, anëtarët e organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar u nënshtrohen edhe rregullave të statutit apo rregullave të tjera të brendshme. Rregullat e brendshme të organizatës profesionale të kontabilistëve të miratuar miratohen nga mbledhja e përgjithshme e anëtarëve dhe parashikojnë rregulla për vendosjen dhe zbatimin e masave disiplinore.
7. Organizatat Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar duhet të sigurohen që anëtarët e tyre veprojnë në pajtueshmëri me kuadrin rregullator në fuqi dhe standardet e etikës së miratuar nga BMP në përputhje me dizpozitat e parashikuara në Ligjin nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar.
8. Kontabilisti i Miratuar mund ta ushtrojë profesionin:
  - a) në mënyrë individuale, i regjistruar në përputhje me ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar;
  - b) si një ortak/aksionar pjesëmarrës në kapitalin e një shoqërie të kontabilistëve të miratuar.
  - c) i punësuar te një tjetër kontabilist i miratuar i regjistruar apo shoqëri kontabiliteti.
9. Funkzioni i Kontabilistit të Miratuar është i papajtueshëm me çdo angazhim, si i punësuar, me përjashtim të:
  - a) rasteve të parashikuara në pikën 8 të këtij neni;
  - b) ushtrimit të veprimtarisë së mësimdhënies me kohë të pjesshme;
  - c) pjesëmarrjes në seminare, konferenca, komisione, komitete, apo veprimtari të ngjashme me to.
10. Angazhimi në një vend pune tjetër përveç rasteve të parashikuara në pikën 8 dhe 9 të këtij neni nuk lejohet me përjashtim të rasteve kur veprimtaria tjetër nuk bie ndesh me ushtrimin e profesionit dhe nuk krijon konflikte interesi. Në këto raste anëtari duhet të kërkojë miratimin nga organizata profesionale përkatëse në të cilën është anëtarë si dhe nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.
11. Në rastin e parashikuar në pikën 10, anëtari duhet të dorëzojë në fund të çdo viti ushtrimor ose për të gjithë periudhën e angazhuar (kur ajo është më e vogël se viti ushtrimor) orët e punës për secilin nga aktivitetet pranë organizatës profesionale përkatëse dhe BMP-së.

## **Neni 4**

### **Edukimi i Vijueshëm**

1. Kontabilistët e Miratuar i nënshtrohen kualifikimit të vijueshëm profesional, i cili është i detyrueshëm dhe zgjat, të paktën, 40 orë në vit. Periodiciteti i kryerjes së kualifikimit të vijueshëm profesional vendoset nga organizata profesionale në përputhje me ligjin në fuqi.
2. Përveç organizimit nga organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar, kurset për kualifikimin e vijueshëm profesional mund të organizohen edhe nga:
  - a) institucione të arsimit të lartë;
  - b) qendra të tjera të kualifikimit profesional, të cilat kanë mjediset dhe personelin e duhur për garantimin e një kualifikimi cilësor, në përputhje me programet e miratuara për kualifikimin e vazhdueshëm profesional;
  - c) shoqëri të kontabilitetit, të cilat kanë kapacitete për të organizuar kualifikimin për të punësuarit e vet.
3. Institucionet e arsimit të lartë, qendrat e kualifikimit profesional dhe punëdhënësit e përmendur në shkronjën “c” të pikës 2 të këtij neni, që dëshirojnë të organizojnë kurset e kualifikimit të vijueshëm profesional, vënë në dijeni BMP për këtë fakt dhe pas shqyrtimit prej BMP merr pëlqimin e këtij të fundit, përpara fillimit të kësaj veprimtarie, në përputhje me vendimin e marrë në organet e veta vendimmarrëse.
4. Programi i kualifikimit të vijueshëm të zhvilluar nga subjektet e parashikuara në pikën 2 dhe 3 të këtij neni duhet të ketë të paktën 50 përqind të programit të njëjtë me organizatën profesionale në të cilën KM është anëtar. Pajtueshmëria e parashikuar në paragrafin më sipër bëhet nga organizata profesionale e KM në të cilën bën pjesë anëtari.
5. Në përfundim të çdo kursi, kontabilisti i miratuar pajiset me vërtetimin e plotësimit të detyrimit, si dhe të vlerësimit të marrë. Vërtetimi depozitohet pranë organizatës përkatëse profesionale të kontabilistëve të miratuar në kopje të noterizuar ose origjinale.
6. Këshilli Drejtues i Organizatës Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar, miraton politikat e edukimit të vijueshëm si dhe mënyrën e organizimit, e monitorimit dhe të vlerësimit individual të kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve të saj. Si pjesë e procesit të vlerësimit, Këshilli Drejtues miraton organizimin e testimit të njohurive të marra gjatë kualifikimeve të vijueshme, i cili duhet të bëhet jo më shpesh se një herë në tre vjet dhe jo më rrallë se një herë në pesë vjet.
7. BMP mbikëqyr të gjithë procesin e parashikuar në pikën 6 të këtij neni dhe një herë në 5 vjet mund të organizojë në mënyrë të pavarur procesin e vlerësimit të lidhur me edukimin e vijueshëm.
8. Në përfundim të një procedure të nisur monitorimi, organizata profesionale e kontabilistëve të miratuar publikon rezultatet e monitorimit dhe ia dërgon BMP. Bordi i shqyrton dhe merr vendim për masat që duhen ndërmarrë për rregullimin e situatës.
9. Bordi, gjithashtu, merr vendim për të propozuar pezullimin e ushtrimit të profesionit nga kontabilisti i miratuar, që nuk ka arritur të përfundojë me sukses kualifikimin e

vijueshëm të detyrueshëm, apo çregjistrimin e kontabilistëve të miratuar, të cilët kanë depozituar vërtetime apo dokumente të pavërteta për kryerjen e kurseve të kualifikimit të vazhdueshëm. Propozimet e BMP janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga OP përkatëse.

10. Kopje të vendimeve i dërgohen organizatës përkatëse të kontabilistëve të miratuar, lidhur me marrjen e masave disiplinore në përputhje me rregulloren nr. 4, datë 29.03.2018 “Për Investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore” të miratuar nga BMP. Masat e marra dërgohen pranë komitetit të regjistrimit të organizatës profesionale përkatëse, i cili reflekton ndryshimet në regjistër.
11. Regjistrimi i kontabilistëve të miratuar për të ushtruar profesionin është i përvitshëm. Mospërmbushja e detyrimeve të kualifikimit të vijueshëm është kusht për mosregjistrimin e kontabilistëve të miratuar në listën e publikueshme për të gjithë vitin pasardhës.
12. Organizatat Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar hartojnë rregullat e brendshme për kualifikimin e vijueshëm profesional, si dhe rregullat për regjistrimin dhe çregjistrimin e anëtarëve. Këto rregulla miratohen nga BMP.
13. Organizatat Profesionale të kontabilistëve të Miratuar mund të zhvillojnë programe të tjera për anëtarët e tyre të cilët janë KM aktivë, të cilat mund të lidhen me fusha që prekin ekspertizën e taksave apo çështje të tjera brenda veprimtarisë së parashikuar në kuadrin rregullator. BMP vlerëson dhe miraton këto programe në kuadrin e procesit të mbikëqyrjes dhe mënyrës së zhvillimit së programit të formimit të përgjithshëm të vijueshëm të Kontabilistëve të Miratuar. Në procedurat lidhur me këtë proces, përcaktohen detajet për zbatimin e këtij procesi, së bashku me kostot që lidhen me mbikëqyrjen, shqyrtimin, vlerësimin dhe të tjera çështje të parashikuara në kuadrin rregullator.

## **Neni 5**

### **Dëshmitë që lidhen me Procesin e Edukimit të Vijueshëm**

1. Për të vërtetuar kryerjen e kursit vjetor të edukimit të vijueshëm, OP ose subjektet e tjera të parashikuara, në pikën 2 të nenit 4, të kësaj rregulloreje pajisin subjektin me një dëshmi e cila tregon orët e kryera dhe modulet e trajtuara në programin e edukimit të vijueshëm.
2. Përmbajtja e dokumentit që lëshohet si dëshmi për kryerjen e kursit të edukimit të vijueshëm miratohet nga OP ose subjektet e tjera të parashikuara në ligj dhe në këtë rregullore.
3. Dokumenti duhet të përmbajë elementë që japin informacion ku përfshihen orët e trajnimit, datat e kryerjes së këtij trajnimit, data e lëshimit të dokumentit, modulet e trajtuara dhe një vlerësim për KM lidhur me përvetësimin e njohurive. Gjithashtu, dokumenti duhet të përmbajë informacion ku përfshihen së paku personat përgjegjës për nënshkrimin e dokumentit, nënshkrimet e personave përgjegjës së bashku me vulën e institucionit, si dhe numri rendor i dokumentit.

4. OP dhe subjektet e autorizuar nga BMP mbajnë një regjistër të veçantë lidhur me kryerjen e procesit të edukimit të vijueshëm për secilin nga anëtarët e tyre ose anëtarë të organizatave të tjera profesionale kur kjo është e parashikuar në memorandumet apo marrëveshje bashkëpunimi midis organizatave profesionale apo si rrjedhojë e kërkesave të kuadrit rregullator.
5. Në regjistër evidentohen për secilin KM, të paktën, të dhënat në lidhje me orët e trajnimit, datën e kryerjes së trajnimit, data e lëshimit të dokumentit, modulet e trajtuara, si dhe vlerësimi lidhur me përvetësimin e njohurive, të cilat mund të jenë subjekt i mbikëqyrjes së BMP-së.

## **Neni 6**

### **Verifikimi i Përputhshmërisë Ligjore të Veprimtarisë së Kontabilistëve të Miratuar**

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike, të paktën një herë në 5 vjet, në bashkëpunim me OP-të organizon procesin e verifikimit të përmbushjes së kërkesave ligjore lidhur me ushtrimin e profesionit të kontabilistit të miratuar përmes një komisioni ad-hoc të ngritur pranë tij.
2. Procesi i verifikimit bëhet për të gjithë zotëruesit e titullit Kontabilist i Miratuar pavarësisht nëse janë KMA apo KMJ. Për këta të fundit, procesi i verifikimit kryhet në momentin kur kërkojnë të reregjistrohen, duke mbuluar edhe periudhën kur e kanë ushtruar profesionin.
3. Verifikimi përfshin kontrollin e kryerjes së edukimit të vijueshëm, rregullsinë e dokumentacionit lidhur me fitimin e titullit KM, me momentin e regjistrimit në OP pas marrjes së titullit KM, marrëdhëniet e punës apo angazhimit përgjatë 5 viteve të fundit dhe pajtueshmërinë me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe verifikimin e dosjes personale të lidhura me çështjet gjyqësore dhe dëshmisë së penaltetit. Procesi i verifikimit do të përfshijë gjithashtu çështje të cilat bien ndesh me Kodin e Etikës për ushtrimin e profesionit apo me legjisllacionin në fuqi.
4. Në fund të procesit bëhet një vlerësim lidhur me pajtueshmërinë ligjore dhe secili subjekt për të cilin dëshmohet se janë përmbushur kriteret ligjore pajiset nga BMP me një kartë profesionale, e cila dëshmon të drejtën për të vijuar ushtrimin e profesionit në periudhën në vijim.
5. Në rastet kur ka evidencë apo dëshmi të papajtueshmërisë ligjore për secilin subjekt bëhet një vlerësim brenda periudhës në të cilin merret informacioni dhe procedohet në përputhje me “Rregulloren për Investigimin dhe Marrjen e Masave Disiplinore”.
6. Procesi i periudhës së verifikimit bëhet brenda një periudhe 6 mujore nga moment i afatit përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit. Dokumentacioni dorëzohet pranë BMP drejtpërdrejtë nga subjekti ose pranë OP ku subjekti është i anëtarësuar. Në rastet kur dorëzohen pranë OP-ve, këto të fundit, i dorëzojnë dokumentet, brenda tre ditëve, pranë BMP.
7. Në rastet kur subjektet e parashikuara në këtë rregullore nuk kanë dorëzuar dokumentacionin brenda afateve të parashikuara në këtë rregullore, veprimtaria e tyre pezullohet si pasojë e mos-përfshirjes në regjistrat publikë të OP-ve.

8. Të gjithë ato subjekte që duan të përfshihen në këtë proces pas afateve të përcaktuara në këtë rregullore duhet të bëjnë një kërkesë me shkrim pranë BMP, i cili merr në shqyrtim rastin dhe brenda një periudhe 3 mujore vendos nisjen e procesit të verifikimit.
9. Në rastet e parashikuara në pikën 8 të këtij neni kostot shtesë që lindin nga kryerja e procesit jashtë afateve të parashikuara përballohen nga subjekti në përputhje me përlogaritjet e propozuara nga përgjegjësi për financat pranë SM-së të BMP dhe të miratuara nga BMP.
10. Të gjitha subjektet të cilat përgjatë procesit kalojnë në statusin pasiv duke u tërhequr përkohësisht nga ushtrimi i profesionit apo që deri në momentin e kryerjes së procesit të verifikimit nuk kanë qenë ushtrues të profesionit janë të detyruar të kalojnë në proces verifikimi sikurse të gjitha subjektet e parashikuara në këtë rregullore përpara se të regjistrohen në regjistrin publik për të vijuar më pas me ushtrimin e profesionit.
11. Dokumentacioni që do të jetë pjesë e vlerësimit paraqitet si më poshtë:
  - a) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
  - b) Dëshmi penalteti;
  - c) Certifikata e titullit KM;
  - ç) Numri i identifikimit të personit të tatueshëm (certifikatë NIPT);
  - d) Vërtetim nga OP përkatëse:
    - i. për rezultatet e kontrollit të cilësisë realizuar nga OP përkatëse (në rastet kur janë kryer);
    - ii. nëse janë marrë masa disiplinore ose jo nga OP përkatëse;
    - iii. për kryerjen me sukses të kualifikimit të vijueshëm për 5-vitet e fundit;
  - dh) Vërtetim nga sigurimet shoqërore për marrëdhëniet e punësimit, për 5 vitet e fundit. Në rast se individi ka qenë jashtë vendit, si dokument vërtetimi shërbejnë kontratat dhe certifikatat e punësimit (fotokopje të noterizuara);
  - e) Të tjera të përcaktuara me vendim të BMP, në përputhje me kuadrin rregullator.
12. Lista e dokumenteve u vihet në dijeni OP-ve të cilat duhet ta përcjellin te anëtarët e tyre, si dhe publikohet në faqen zyrtare të OP-ve dhe në faqen zyrtare të BMP-së.
13. Të gjithë dokumentet, bazuar në listën sipas pikës 11 të këtij neni, që disponohen nga OP-të vihen në dispozicion të Komisionit ad-hoc, drejtpërdrejtë nga OP-të përkatëse.

## **Neni 7**

### **Komisioni për verifikimin e Përputhshmërisë Ligjore të Veprimtarisë së Kontabilistëve të Miratuar**

1. Komisioni ose grupi i punës për verifikimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit anëtare të OP do të ketë një kohëzgjatje të përkohshme (ad-hoc) deri në mbyllje të procesit të verifikimit. Ky komision ngrihet një herë në 5 vjet në mënyrë që të përmbush dispozitat e parashikuara në këtë rregullore, për të garantuar kryerjen e shërbimeve cilësore nga kontabilistët e miratuar në funksion të mbrojtjes së interesit publik.



2. Së paku, një nga anëtarët e komisionit duhet të jetë jurist dhe të ketë njohuri mbi ligjin nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar dhe legjislacionin që prek veprimtarinë e KM. Anëtarët e komisionit (grupit të punës) mund të jenë nga SM përkatëse ose ekspertë të jashtëm të angazhuar në përputhje me kuadrin rregullator të BMP-së, për të përmbushur realizimin e procesit të parashikuar në nenin 6 të kësaj rregullore.
3. Gjatë realizimit të procesit të verifikimit të KM, ky komision mund të asistohet edhe nga personel shtesë i strukturës mbështetëse. Gjithashtu, si pjesë e kësaj strukture mund të asistojnë OP të cilat mund të grumbullojnë informacionin e parashikuar sipas kësaj rregullore për anëtarët e tyre dhe ta dorëzojnë pranë BMP, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.
4. Përveç sa parashikohet në neni 6 të kësaj rregullore, në objektin e punës së komisionit ad-hoc do të jetë edhe verifikimi i kryqëzuar me informacionet e publikuara në Qendrën Kombëtare të Biznesit i të gjitha subjekteve të cilat janë subjekt i këtij verifikimi.
5. Programi i punës së bashku me kalendarin e mbledhjeve propozohet nga PPM dhe miratohet nga BMP.
6. Komisioni, 15 ditë pune mbas përfundimit të çdo muaji kalendarik, dorëzon pranë BMP një raport mbi ecurinë e procesit dhe problematikat e hasura së bashku me rekomandimet dhe çështjet e mbetura pezull të cilat ndiqen deri përpara mbylljes së veprimtarisë së tij. Gjithashtu, përveç raportit të ecurisë, komisioni dorëzon pranë BMP të gjitha rastet e shqyrtuara në atë moment së bashku me rekomandimet përkatëse për secilin nga subjektet e verifikuara.
7. BMP pasi merr raportet e dorëzuara nga Komisioni i shqyrton ato dhe i adreson për t’u trajtuar në përputhje me rregulloren nr. 4, datë 29.03.2018 “Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore”.
8. Veprimtaria e komisionit është e lidhur me veprimtarinë e mbylljes së procesit të verifikimit të KM sipas nenit 6 të kësaj rregullore dhe nuk duhet të jetë më shumë se një periudhë 6 mujore. Zgjatja e veprimtarisë së komisionit dhe procesit të verifikimit bëhet vetëm me vendim të BMP.
9. Në rast se përgjatë punës së tyre komisioni identifikon subjekte të cilat kryejnë veprimtari në papajtueshmëri me kërkesat ligjore, komisioni duhet të vendosë në dijëni BMP përmes një raporti në mënyrë që të trajtohet më tej.
10. Komisioni i parashikuar në këtë nen ngrihet brenda 30 ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore.
11. Anëtarët e Komisionit mund të shkarkohen nga detyra nëse:
  - a) anëtari nuk paraqitet në mbledhje tre herë radhazi apo më shumë se pesë mbledhje përgjatë mandatit të parashikuar në këtë rregullore;
  - b) kur veprimet apo mosveprimet e tij dëmtojnë rëndë veprimtarinë dhe emrin e BMP-së dhe profesionit;
  - c) kryen veprime të paligjshme apo që çënojnë rëndë imazhin e Komisionit dhe BMP-së;

- ç) kur ka marrë më shumë se dy vërejte me shkrim nga kryetari i BMP-së për shkelje apo sjellje të papajtueshme me kuadrin rregullator në fuqi (në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje);
  - d) kur nuk përmbush funksionet e parashikuara nga ligji dhe kjo rregullore;
  - dh) përfshihet në veprime të dhunshme duke ushtruar dhunë fizike;
  - e) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - ë) ka konflikt interesi me funksionin e vet.
12. Bordi i Mbikëqyrjes Publike mund të bëjë pezullimin e menjëhershëm të secilit prej anëtarëve në rastet kur ndaj tyre:
- a) konstatohet shkelje e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi;
  - b) ka nisur proces investigimi lidhur me veprimtarinë e tij që lidhet me ushtrimin e detyrës si anëtar i Komisionit, të cilat çënojnë imazhin e Komisionit dhe BMP-së;
  - c) përfshihet në konflikte të cilat përfshijnë dhunën fizike apo presionin verbal që vë në kërcënim jetën, pasurinë, punën apo karrierën e cilito personi, përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së funksioneve të veta si anëtar i Komisionit ose që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë si anëtar i Komisionit;
  - ç) për çdo rast tjetër që parashikohet nga kuadri rregullator në fuqi.

## **Neni 8**

### **Regjistri Publik i Organizatave Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar**

1. Organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar janë përgjegjëse për:
  - a) mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit publik të kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit;
  - b) identifikimin e kontabilistëve të miratuar dhe të shoqërisë së kontabilitetit në regjistrin publik, me një numër individual.
2. Informacioni për regjistrimin mbahet në format elektronik dhe vihet në dispozicion të publikut nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar të njohura nga BMP.
3. Format i regjistrit publik të kontabilistëve të miratuar, miratohet nga bordi dhe ai duhet të parashikojë të paktën dy seksione të organizuara, përkatësisht, si seksioni i kontabilistëve të miratuar dhe seksioni i shoqërive të kontabilitetit.
4. Regjistri i konsoliduar i kontabilistëve të miratuar publikohet në faqen zyrtare të BMP.
5. Të dhënat e regjistrit i vihen në dispozicion Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe imsitucioneve të tjera, në përputhje me legjislacionin e fushës.

## **Neni 9**

### **Regjistrimi i Kontabilistëve të Miratuar dhe Shoqërive të kontabilitetit pranë Organizatave Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar**

1. Organizatat profesionale krijojnë një komitet për zbatimin e procedurave të regjistrimit në regjistrin publik të KM-ve dhe shoqërive të kontabilitetit. Regjistrimi i KM-ve është procesi i përfshirjes së tyre në regjistrin publik të OP-ve.

2. Kërkesa e kandidatit për regjistrim i adresohet, me shkrim, Komitetit të Regjistrimit, të krijuar pranë organizatës profesionale ku dëshiron të anëtarësohet.
3. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet e nevojshme, që tregojnë për përfundimin me sukses të provimeve të aftësisë profesionale, si dhe të deklaratës së lëshuar në përgjegjësinë personale të individit, për dhënien fund të papajtueshmërive, që kërkohen për ushtrimin e profesionit në praktikë dhe për garancitë etike e morale.
4. Komiteti i Regjistrimit me vendim përfshin KM në regjistrin publik, që mbahet dhe përditësohet nga organizata profesionale përkatëse. Vetëm pas kësaj përfshirjeje, ata kanë të drejtë të kryejnë shërbimet e kontabilitetit.
5. Komitetit i Regjistrimit pranë OP, regjistron një shoqëri kontabiliteti për kryerjen e shërbimeve të kontabilitetit, në qoftë se shoqëria e kontabilitetit plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 5, të nenit 3 të kësaj rregulloreje.

### **Neni 10**

#### **Revokimi i kartës profesionale dhe çregjistrimi i Kontabilistëve të Miratuar nga regjistri publik i Organizatave Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar**

1. Kontabilistit të Miratuar i revokohet karta profesionale dhe fshihet përfundimisht nga regjistri publik i kontabilistëve të miratuar të organizatës profesionale në rastet kur:
  - a) heq dorë nga e drejta për ushtrimin e profesionit. Heqja dorë bëhet nëpërmjet deklaramit me shkrim, i cili paraqitet pranë Komitetit të regjistrimit të OP-ve përkatëse, kopje e të cilit i dërgohet dhe BMP-së;
  - b) konstatohen parregullsi në:
    - i. dokumentet e nevojshme, të lidhura me provimet e aftësisë profesionale;
    - ii. deklaramet, të cilat rezultojnë të pavërteta, në lidhje me dhënien fund të papajtueshmërive, që kërkohen për ushtrimin e profesionit në praktikë dhe për garancitë etike e morale, të dorëzuara në çastin e bërjes së kërkesës për regjistrimin e parë në regjistrin publik;
    - iii. dokumentet dhe në faktet e deklaruara gjatë procedurave të mundshme të pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të profesionit.
  - c) në përfundim të një procedure disiplinore ndaj tij, është marrë masa disiplinore e çregjistrimit nga regjistri publik;
  - ç) për shkak të shkeljeve dhe masave disiplinore të përsëritura, reputacioni i të regjistruarit është cënuar ndjeshëm;
  - d) në përputhje me dispozitat e ligjit dhe rregullatore, OP ka vendosur çregjistrimin nga regjistri publik;
  - dh) të tjera çështje të parashikuara në ligj.
2. Shoqëria e kontabilitetit fshihet përfundimisht nga regjistri publik i kontabilistëve të miratuar në rastet kur:
  - a) përfundon afatin e ushtrimit të veprimtarisë së parashikuar në statutin e vet;
  - b) e drejta për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri kontabiliteti hiqet nga OP.

3. Një anëtar i OP të KM, person fizik, mund të ç'regjistrohet përkohësisht nga regjistri publik i Organizatave Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar kur nuk ka realizuar detyrimet e lidhur me kursin e edukimit të vijueshëm ose kur nuk ka paguar kuotat e anëtarësisë.

## **Neni 11**

### **Njohja e Organizatave Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike**

1. Statuti i OP hartohet në përputhje me kërkesat e ligjit për OJF-të, të Ligjit nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, dhe vendimeve të bashkuara me kuadrin rregullator të BMP-së.
2. Statuti duhet të përmbajë dispozita lidhur me detyrimin e anëtarëve dhe strukturave drejtuese të organizatës për ndjekjen e standardeve profesionale të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC), cilësisht të larta dhe që në tërësi dhe në mënyrë të veçantë përmbushin kërkesat dhe standardet e vendosura në Deklaratat e Detyrimeve të Anëtarësisë së IFAC (SMO-të), si dhe për zbatimin e një kodi etike, që është në pajtim me kodin e etikës së IFAC. Statuti i Organizatave Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar dhe çdo ndryshim i tij miratohet nga BMP.
3. Bordi i Mbikëqyrjes Publike konsideron si në përputhje me kërkesat ligjore,
  - a. të gjitha organizatat profesionale që përfaqësojnë Kontabilistët e Miratuar të cilat janë anëtare me të drejta të plota në IFAC,
  - b. të gjitha organizatat profesionale që përfaqësojnë Kontabilistët e Miratuar të cilat janë anëtare shok në IFAC, dhe dokumentojnë që kanë në zbatim struktura dhe praktika të funksionimit që janë në përputhje me standardet e IFAC,
  - c. të gjitha organizatat profesionale që vërtetojnë në mënyrë të dokumentuar pranë BMP se kanë në zbatim struktura dhe praktika të funksionimit që janë në përputhje me standardet e IFAC. Në këto raste, BMP mund të kërkojë edhe opinionin e IFAC, për çështje të caktuara.
4. Vetëm ato organizata që vërtetojnë plotësimin e njërit nga tre parashikimet e mësipërme, do të kenë të drejtë të përfaqësojë Kontabilistët e Miratuar në kuptimin e parashikimeve të ligjit nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, dhe do të marrin autorizim me shkrim me vendim të posaçëm të BMP.
5. Anëtarët e organeve drejtuese duhet të jenë pjesë e anëtarësisë dhe më shumë se gjysma e tyre duhet të jenë KMA. Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjidhen për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë. Kufizimet e ripërtëritjes së mandateve të organeve të drejtimit të OP-ve llogariten në përputhje me dispozitat ligjore për ripërtëritjen e mandateve të organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

6. Çdo organizatë që kërkon të funksionojë si organizatë profesionale e Kontabilistëve të Miratuar duhet të bëjë një kërkesë për njohje shoqëruar me dokumentacionin përkatës pranë BMP, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.
7. BMP do të publikojë listën e organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar të njohura prej tij në faqen zyrtare dhe do ta përditësojë atë vazhdimisht për çdo ndryshim të mundshëm.
8. Çdo kontabilist i miratuar, sipas përcaktimeve të nenit 51 “E drejta e ushtrimit të profesionit”, pika 2, gërma a dhe ç, të ligjit të auditimit, duhet të verifikojë nëse organizata ku është anëtar është e njohur ose jo nga BMP dhe të bëjë veprimet e nevojshme për përmbushje të këtij kriteri.
9. Çdo anëtar duhet të përmbushë plotësisht detyrimet e anëtarësisë pranë organizatës përkatëse siç përcaktohen në statutin dhe aktet e brendshme të vetë organizatës si dhe në kërkesat e ligjit të auditimit.
10. Çdo organizatë profesionale e kontabilistëve të miratuar duhet të publikojë në faqen zyrtare të internetit statutin më të fundit si dhe ndryshimet respektive të statutit sipas periudhave kur kanë ndodhur këto ndryshime. Gjithashtu, këto organizata duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit Kodin e Etikës.
11. Organizatat Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar duhet të publikojnë në faqen e internetit të gjitha rregulloret dhe vendimet e miratuara nga organet përkatëse në përputhje me statutin e tyre, të cilat prekin veprimtarinë e organizatës dhe anëtarësisë së saj.

## **Neni 12**

### **Mbikëqyrja e Organizatave Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar**

1. Mbikëqyrja e Organizatave Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar bëhet nga inspektorët përkatës të BMP-së në pajtim me kuadrin rregullator të BMP. OP-të janë të detyruara të vënë në dispozicion të inspektorëve të gjithë informacionin e nevojshëm i cili mundëson mbikëqyrjen e funksionimit dhe pajtueshmërinë me dispozitat ligjore në fuqi. Mbikëqyrja e OP-ve bëhet sipas një kalendari pune të brendshëm në të cilin përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e SM që do jetë pjesë e grupit të inspektimit. OP janë të detyruara të dorëzojnë pranë SM informacionin e kërkuar në mënyrë fizike pranë zyrave të BMP ose përmes postës elektronike zyrtare të BMP. Inspektimi përfshin verifikimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të OP-ve të kryer në përputhje me standardet e IFAC, që lidhen me çështje të:
  - a. Programit të Edukimit të Vijueshëm për anëtarët e OP;
  - b. Përmbajtjen dhe përditësimin e Regjistrit Publik të KM;
  - c. Kontrollit të cilësisë së kryer ndaj anëtarëve të tyre;
  - ç. Vendimet dhe aktet e marra nga organet e drejtimit dhe pajtueshmërinë e tyre me kuadrin rregullator;
  - d. Trajtimin e ankesave të ardhura pranë tyre nga anëtarë të organizatës apo informacione të tjera;
 dh. Veprimtarinë e Komisioneve dhe Komiteteve të ngritura pranë OP për çështje të

- lidhura me zbatimin e Kodit të Etikës, dispozitave ligjore, çështjeve të lidhura me investigimin dhe masat disiplinore;
- e. Vendime dhe rekomandime të dhëna nga BMP të detyrueshme për zbatim nga OP-të;
  - ë. Veprimtari të tjera të cilat mund të sjellin shkeljen e kuadrit rregullator apo që në mënyrë të drejtpërdrejtë mund të çënojnë imazhin e profesionit dhe interesin e publikut;
  - f. Raportet e Auditimit të audituesit ligjor lidhur me veprimtarinë financiare të OP-ve
  - g. Çështje dhe kërkesa të lidhura me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
  - gj. Të tjera çështje të parashikuara në ligj dhe në kuadrin rregullator të BMP-së.

### **Neni 13**

#### **Ç'regjistrimi nga lista e OP-ve të njohura nga BMP**

1. Në rastet kur si rrjedhojë e veprimeve direkte ose indirekte të organizatave profesionale vërtetohet apo ka evidenca për shkeljen e kuadrit rregullator në fuqi, duke çënuar interesat e profesionit, BMP thërret asamblenë e përgjithshme të anëtarëve të organizatave profesionale respektive për të komunikuar çështjet në fjalë. BMP në këto mbledhje propozon masat që duhet të ndërmerren nga asambleja e përgjithshme për të rregulluar veprimet e papajtueshme.
2. Në varësi të rasteve të cilat sjellin shkelje dhe papajtueshmëri të kuadrit rregullator të cilat sjellin dëmtimin e interesit të publikut BMP mund ti kërkojë asamblesë të pezullojë Këshillin e Drejtimit të OP dhe të ngrëjë një grup drejtimi teknik deri në zgjidhjen e këtyre papajtueshmërive.
3. Masat e parashikuara, të cilat rrjedhin nga pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk përjashtojnë nga përgjegjësia individuale dhe procedimi në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të ushtruesit të profesionit KM, të cilët kanë qenë përgjegjës për shkaktimin e këtyre shkeljeve.
4. Përveç rasteve të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni BMP mund të kërkojë pezullimin ose përjashtimin e OP nga lista e njohur e OP-ve kur evidentohet që OP mashtrojnë me listat e anëtarësisë apo me proceset e edukimit të vijueshëm profesional dhe procesin e kontrollit të cilësisë, si dhe në rastet kur janë përfshirë në veprime që përbëjnë kundërvajtje penale.
5. Në rastet kur BMP merr një vendim pezullimi, anëtarët të cilët nuk kanë kryer edukimin e vijueshëm përgjatë vitit duhet ta kryejnë atë në një nga OP-të e tjera të njohura nga BMP.
6. Për rastet, të cilat BMP si rrjedhojë e shkeljeve të parashikuara më sipër ka marrë një vendim për ç'regjistrimin e OP, anëtarët e kësaj organizate duhet të regjistrohen në një nga organizatat e tjera të njohura nga BMP brenda 30 ditësh nga marrja e vendimit.
7. Në rastet e parashikuara në pikën 6 të këtij neni, BMP në vendimin e pezullimit parashikon edhe procedurën që do të ndiqet për regjistrimin e anëtarëve në një OP tjetër.

## **Neni 14**

### **Dispozita Përfundimtare**

1. Të gjitha organizatat profesionale të interesuara për të përfaqësuar kontabilistët e miratuar në kuptimin e ligjit të auditimit, duhet të paraqesin kërkesën për njohje si organizatë profesionale që do të përfaqësojë kontabilistët e miratuar të shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Periudha e njohjes do të jetë për 5 vite. Në rast të ndryshimeve ligjore të cilat prekin aktivitetin apo standardet të cilat lidhen me veprimtarinë e organizatave peridha e njohjes mund të jetë më pak se 5 vite. Tarifa e aplikimit për të realizuar procesin e njohjes së organizatave profesionale, do të jetë 300,000 lekë.
2. Dispozitat e pikave 3 dhe 4 të nenit 11 të kësaj rregullorje, zbatohen deri 12 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore. Brenda kësaj periudhe OP-të ekzistuese dhe ato të interesuara mund të aplikojnë për të përfaqësuar kontabilistët e miratuar. Në përfundim të periudhës tranzitore, do të bëhet njohja dhe publikimi i OP-ve të njohura nga BMP, pas verifikimit të kriterëve të pikave 3 dhe 4, të nenit 11.
3. Në rast se pas përfundimit të periudhës tranzitore ndonjë nga OP, nuk plotëson kushtet e parashikuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 11, ajo nuk përfshihet në listën e OP-ve të njohura nga BMP dhe që publikohet në faqen zyrtare të BMP-së.
4. Në rastin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni, të gjithë anëtarët e OP, e cila nuk përfshihet në listën e OP-ve të njohura të publikuar në faqen e BMP, brenda një periudhe 30 ditore duhet të regjistrohen në një nga organizatat e tjera të njohura nga BMP. Në këtë rast, BMP parashikon me vendim të veçantë procedurën që do të ndiqet për regjistrimin e anëtarëve në një OP tjetër.
5. Për periudhën tranzitore të gjitha OP ekzistuese të kontabilistëve të miratuar duhet të sjellin brenda datës 31 Mars 2019 statutin e tyre për të miratuar pajtueshmërinë e tyre në përputhje me ndryshimet ligjore dhe kuadrin rregullator në fuqi apo rifreskime të bëra prej organizatave.
6. Procesi i verifikimit të KM-ve, parashikuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje, do të kryhet për herë të parë brenda një periudhe gjashtëmujore nga momenti i ngritjes së komisionit të parashikuar në nenin 7 të kësaj rregullore.
7. Për të realizuar procesin e parë të verifikimit kontabilistët e miratuar duhet të dorëzojnë brenda datës 30 Prill 2019 të gjithë dokumentacionin e parashikuar në këtë rregullore në mënyrë fizike ose elektronike.
8. Tarifa për të realizuar procesin e verifikimit dhe pajisjen me kartën profesionale, të parashikuar në nenin 6 të kësaj rregullore, do të jetë 48.000 lekë për secilin subjekt të verifikimit. Karta profesionale është e vlefshme për 5 vite. Format i kartës miratohet me vendim të veçantë të BMP-së.
9. Organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar të marrin masat për njoftimin e anëtarëve të tyre, si dhe organizimin kualifikimeve të vijueshme intensive brenda afateve të parashikuara në pikën 6 të këtij neni, me qëllim krijimin e mundësive që të gjithë anëtarët e tyre të plotësojnë kërkesat ligjore të kualifikimit të vijueshëm.

10. Në rastin e pamundësisë së kryerjes së kualifikimit të vijueshëm brenda periudhës së parashikuar në pikën 6 të këtij neni, anëtarët e organizatave profesionale do të lejohen të plotësojnë këtë kriter deri në 31 Dhjetor 2019. Deri në plotësim të këtij kriteri anëtari do të pajiset me kartë profesionale (pasi ka plotësuar të gjitha kriteret e tjera), e cila do të jetë objekt revokimi në rast se në përfundim të këtij afati rezulton që kriteri të mos jetë përmbushur.
11. OP ekzistuese duhet të dorëzojnë listën e anëtarëve që kanë kryer kursin e edukimit të vijueshëm brenda datës 15 Mars 2019 për të gjithë anëtarët për 5 vitet e fundit.
12. Dispozitat e kësaj rregullore nuk zbatohen për Audituesit Ligjorë/Shoqëritë e Auditimit që ofrojnë shërbime kontabiliteti, ose të cilët janë të anëtarësuar si anëtarë pasivë në organizatën profesionale të audituesve ligjorë dhe kryejnë shërbimet e kontabilitetit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rregullimi i tyre bëhet në përputhje me Ligjin nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar dhe rregullimet përkatëse që prekin Audituesit Ligjor dhe Shoqëritë e Auditimit të miratuara nga BMP.
13. Në përfundim të procesit të verifikimit përgatitet regjistri publik për secilën OP. Regjistri i konsoliduar publikohet në faqen e BMP-së.
14. Pas përgatitjes së regjistrit publik, sipas pikës 14 të këtij neni, KM e regjistruar në njërën prej OP-ve kanë të drejtë të ndryshojnë OP-në, vetëm nëse përmbushin kushtet e mëposhtme:
  - a. Kanë përmbushur të gjitha detyrimet statutores ndaj OP ku janë të anëtarësuar, duke e verifikuar këtë me një vërtetim nga OP përkatëse;
  - b. Kanë shlyer të gjitha detyrimet si dhe përfunduar me sukses të gjitha proceset e kualifikimit të vijueshëm, duke e verifikuar këtë me një vërtetim nga OP përkatëse;
  - c. Janë vlerësuar pozitivisht në procesin e verifikimit të pajtueshmërisë ligjore të kryer nga komisioni ad-hoc i ngritur pranë BMP.
  - ç. Janë vlerësuar pozitivisht në një proces kontrolli cilësie nga OP përkatëse. Në rastet kur procesi i vlerësimit ka rezultuar me probleme/negativ, apo nuk është realizuar, KM para se të anëtarësohet në OP-në tjetër i nënshtrohet një procesi të kontrollit të cilësisë nga OP ku KM dëshiron të anëtarësohet.
15. Të gjitha çështjet të lidhura me qëllimin dhe objektin e kësaj rregulloreje që nuk janë parashikuar në këtë rregullore dhe në rregulloret e tjera, do të rregullohen me vendime të veçanta të BMP-së, si dhe nga legjislacioni në fuqi.
16. Ngarkohen për zbatimin e kësaj rregulloreje Bordi i Mbikëqyrjes Publike, Organizatat Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar, subjektet që zotërojnë titullin Kontabilist i Miratuar, dhe të gjitha strukturat e krijuara në zbatimin të kësaj rregullore.

**Kryetar**

**Dritan Fino**